



## Departamenti i Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.11.2022 të parashtruar nga OE – personi fizik “**Liridon Shahini**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Shërbime për konsulence për angazhimin e 10 eksperteve për projekte profesionale – loto 10**”, me Nr. të Prok: 616 22 7459 111 dhe numër të brendshëm: 616 22 109 111 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE – person fizik “**Liridon Shahini**” të dt. 14.11.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Shërbime për konsulence për angazhimin e 10 eksperteve për projekte profesionale – loto 10**” me numër të prokurimit 616 22 6983 211, kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK –së*, të datës 09.11.2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. Vërtetohet *Njoftimit mbi Vendimin e AK –së* i publikuar me datë: **09.11.2022**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit për tenderin “Shërbime për konsulence për angazhimin e 10 eksperteve për projekte profesionale – loto 10”, me Nr. të Prok: 616-22-6983 211, sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës: 09.11.2022.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

OE – person fizik “**Liridon Shahini**” me datë 14.11.2022, ka parashtruar kërkesat për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Shërbime për konsulence për angazhimin e 10 eksperteve për projekte profesionale – loto 10**”, me Nr. të Prok: 616-22-6983/211

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.11.2022, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë.

AK duke u mbështetur ne Parimet e përgjithshme te LPP , përkatësisht ne nenin 7 Barazia ne trajtim / jo diskriminim qe thotë se AK do ti trajtoj operatorët ekonomik ne mënyrë te barabarte jo diskriminuese dhe ne mënyrë transparente, ka bere vlerësimin e ofertave.

AK bazuar ne kriteret e dhënies se kontratës siç është çmimi ekonomikisht me i favorshëm ka bere qe OE – personi fizik “Denis Krasniqi” te arrij numrin me te madh te poenave andaj edhe te renditet si i pari dhe te propozohet për kontrate për loton e 10.

Keni parasysh se çmimi i dhënë nga OE – personi fizik “Denis Krasniqi” është po ashtu çmim me ilirë andaj edhe ka marr totalin e poenave te caktuara per çmim me te lire, ku ka bere qe te renditet si si pari per loton 10.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Prishtina: datë, 16.11.2022

Nexhmi Mekolli

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

Nexhmi Mekolli